

inspektoriati
i punës



ANALIZË STATISTIKORE E TREGUESVE TË INSPEKTIMIT

Informacion i përpunuar i të dhënave të inspektimeve për periudhën Janar-
Gusht 2019, raportuar nga 12 Degët Rajonale të SHPSHSH-së

Janar-Gusht 2019

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore si një organ i qeverisjes qendrore, është përgjegjës për zbatimin e legjislacionit të punës nga të gjithë, punëdhënës e punëmarrës që ushtrojnë veprimatrinë e tyre në Republikën e Shqipërisë.

Veprimaria e këtij institucioni e mbështetur në dy ligjet bazë të inspektimit, Ligji Nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe Ligji Nr. 9634, datë 30.10.2006 “Për Inspektimin e Punës”, i ndryshuar, konsiston në vizita inspektuese, këshilluese e kontrolluese, të cilat shoqërohen me masa specifike për çdo rast inspektimi, në funksion të zbatimit me rigorozitet të legjislacionit të punës.

Gjatë periudhës së 8-mujorit, Janar-Gusht 2019, Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore ka kryer gjithsej 9181 inspektime në subjekte Private dhe Shtetërore, e ku rezultojnë 2298 inspektime më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë.

Të dhënat e inspektimeve

Inspektime Total (Private+Shtetërore)

<i>8 mujore 2018</i>	6,883
<i>8 mujore 2019</i>	9,181

Procesi i inspektimit të punës për muajin Janar- Gusht 2019 ka pasur në fokus, si pjesë e punës së secilit inspektor në misionin e tij, sigurimin e zbatimit të dispozitave ligjore për:

- ✓ Sigurimin e çdo punëmarrësi informal,
- ✓ Ligjshmërinë në zbatimin e kohëzgjatjes së punës,
- ✓ Pagesën për punë të kryer konform legjislacionit,
- ✓ Higjenën dhe mirëqenien në vendin e punës,
- ✓ Punësimin e ligjshëm të fëmijëve,
- ✓ Si dhe çështje të tjera, që lidhen ngushtë me marrëdhënien e punës,

Gjatë këtyre muajve janë trajtuar 555 ankesa, nga të cilat 362 kanë shkuar me inspektim-ankese thënë ndryshe 4% të inspektimeve të kësaj periudhe, kanë rezultuar për raste ankesa.

Orientimi i inspektimeve ka synuar:

- ✓ Minimimizimin e punës informale nëpërmjet forcimit të kontrollit, dhe marrjes së masës administrative “pezullim” për çdo punëmarrës të evidentuar në punë pa siguracion, dhe sigurimin e tij konform legjislacionit, pa të cilin nuk lejohet të vazhdojë punën. Të dhënat e inspektimeve të kësaj periudhe tregojnë se nga 2063 punëmarres informal të konstatuar, 679

prej tyre janë konstatuar në inspektime të programuara, 1248 punëmarrës informal janë konstatuar në inspektimet jashtë planifikimi, si çështje hapur me indicie për shkelje flagrante të ligjit, dhe 129 punëmarrës informal janë konstatuar në inspektimet për shkak ankese.

- ✓ Rritja e besueshmërisë, nëpërmjet trajtimit dhe dhënies zgjidhje të ankesave të ardhura nga punëmarrës dhe punëdhënës
- ✓ Orientimi i kontrolleve drejt aktiviteteve ekonomike që paraqesin rrezikshmëri të lartë për siguri e mirëqenie në punë të punëmarrësit
- ✓ Monitorimi i vazhdueshëm i punës nga portali ndaj gjithë strukturës inspektuese, duke ofruar mbështetje për kryerjen në mënyrë sa më korrekte të detyrës.
- ✓ Rritjen e kujdesit shoqëror komunitar, në reaspektim të standarteve të reja për këtë tipologji, por edhe rritja e kapaciteteve të pushtetit vendor për ofrimin e këtzre shërbimeve në përputhje me nevojat e gjithë komunitetit.
- ✓ Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të kujdesit shoqëror, garantimi i respektimit të shërbimeve me qëllim respektimin e të drejtave të përfituesit dhe mbrojtjen e tij nga diskriminimi, dhuna dhe abuzimi, duke vlerësuar prioritet forcimin e mekanizmave, procedurave të mbrojtjes si dhe rritjen e sensibilitetit të komunitetit ndaj procesit të ankimit.

Vlen të theksohet se, përsa i takon zbatimit të plotë dhe gjithpërfshirës të legjislacionit të punës, ISHPSHSH-ja ka lançuar “Matricën e Dënimeve” si një platformë e aksesueshme në Faqen Zyrtare të institucionit. Kjo platformë, do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e kapaciteteve profesionale të inspektorëve të punës, pasi u jep mundësinë e orientimit të qartë në legjislacionin e punës. Gjithashtu përmes saj, do të mund të sigurojmë një proces inspektimi krejt transparent duke ulur në maksimum abuzimin me detyrën nga inspektorët e punës.

Kështu orientimi i drejtë i inspektimeve dhe përdorimi i kësaj platforme, ka bërë që masat e marra ndaj shkelësve të ligjit të vinë duke u rritur.

Në këto muaj:

Janë inspektuar 9181 **subjekte ekonomike private e shtetërore**.

Janë **197472 vende pune** të inspektuara.

Janë aplikuar 1073 masa administrative “Pezullim” për shkelje flagrante të marrëdhënieve të punës dhe 53 masa administrative “Pezullim” për shkelje flagrante të sigurisë e shëndetit në punë.


Inspektimet e kryera në këtë periudhë, janë rezultat i:

Inspektime të programuara (planifikim apo kerkesa) _____7575

Inspektime për shkak aksident në punë _____118

Inspektime për shkak ankese _____ 362


Inspektime rastësore (me indicie për shkelje flagrante) _____ 1122



Të dhënat mbi inspektimet sipas llojit të inspektimit

Degët Rajonale	Inspektime të programuara (planifikim apo kërkesa)	Inspektime për shkak aksidenti në punë	Inspektime për shkak ankese	Inspektime rastësore (indicia për shkelje flagrante)	% e inspektimeve jashte plani kundrejt totalit te inspektimeve
Berat	387	5	6	124	34%
Diber	199	13	2	36	25.00%
Durres	374	15	34	172	59.00%
Elbasan	628	11	10	88	17.30%
Fier	667	5	9	34	7%
Gjirokaster	176	4	-	2	3.40%
Korce	596	7	7	93	18.00%
Kukes	247	5	2	72	32.00%
Lezhe	313	12	9	73	30.00%
Shkoder	618	5	18	78	16.30%
Tirane	2678	33	230	248	19.00%
Vlore	692	3	35	102	20.20%
Total	7575	118	362	1,122	21.14%

Inspektime jashtë programimi, përbëjnë 21.14 % kundrejt totalit të inspektimeve realizuar në muajt Janar-Gusht 2019, e ku të analizuarra për degë rajonale rezultojnë:



Disa nga treguesit e përgjithshëm statistikorë të inspektimeve realizuar gjatë gjatë kësaj periudhe nga trupa inspektuese e ISHPSHSH-së janë:

1	Subjekte të inspektuara Private + Shteterore	9181
2	Vende pune të inspektuara	197493
	me mesatarisht punm/subjekt	21.5
3	Subjekte private të inspektuara	9135
4	Vende pune të inspektuara në subjektet private	187377
	me mesatarisht punm/subjekt	20.5
5	Punëmarrës pa kontrata individuale të evidentuar	3364
5/1	Punëmarrëse femra pa kontrata individuale	1284
	(punëmarrëset femra pa kontrata zënë 38% e punëmarrësve pa kontrata)	
6	Punëmarrës informal të evidentuar	2063


6/1 Punëmarrëse informale femra të evidentuar	729
7. Punëmarrës informal të futur në skemën e SSH	2009
7/1 Punëmarrëse informale femra të futur në skemën e SSH	716
8 Punëmarrës nën 18 vjeç të evidentuar	224
8/1 Punëmarrëse femra nën 18 vjeç të evidentuara	71
9 Punëmarrës të huaj të evidentuar	854
10 Punëmarrës të huaj, pa leje pune	18
11 Punëmarrës me aftësi të kufizuar	148
11/1 Punëmarrëse femra me aftësi të kufizuar	54
12 Subjekte për të cilët është mbajtur masë administrative “Pezullim” (për shkelje të dispozitave ligjore të marrëdhënieve të punës)	1073
13. Subjekte për të cilët është mbajtur masë administrative “Pezullim” (për shkelje të dispozitave ligjore të sigurisë e shëndetit në punë)	53
14 Subjekte me masën administrative “Paralajmërim”	1127
15. Subjekte me masën administrative Gjobë”	93
16 Vlera totale e sanksioneve	22309000 lekë
17 Inspektive të programuara	7575
18 Inspektive për shkak Ankese	362
19 Inspektive për shkak Aksidenti	118
20 Punëmarrës të aksidentuar	103
21 Punëmarrëse femra të aksidentuara	12
22 Punëmarrës të aksidentuar me vdekje	27

Të ndara sipas llojit të aktiviteteve ekonomike, subjektet e inspektuara rezultojnë:

Aktivitetet ekonomike të inspektuara gjatë këtij muaji, janë në masën 49% aktivitete Tregëti, hotel-bar-restorante, 20% aktivitete prodhuese, 8% inspektime të kryera në ndërtim, 15% aktivitete të tjera. Më konkretisht të dhënat në shifra rezultojnë:

• Bujqësi, pyje, peshkim	140
• Miniera karriera	205
• Ndërmarrje Prodhuese	1807
• Elektricitet, gaz, ujë	91
• Tregti, hotel-bar-restorante	4518
• Ndërtim	734
• Transport, magazinim, telekomunikacion	186
• Financë, shërbime të sigurimeve	105
• Aktivitete të tjera	1395

Inspektime në aktivitetet ekonomike te licensuara, sipas llojit të aktivitetit



Masat e marra ndaj shkelësve të ligjit krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më pare, rezultojnë në rritje me rreth 20%, kjo si rezultat i orientimit të inspektimeve, drejt subjekteve me incie për shkelje të dispozitave ligjore, drejt subjekteve me aktivitet të shtuar e në fluks pune si dhe perdorimit të Matricës së Dënimeve, si pjesë e bindjes ndaj zbatimit të ligjit, nga secili.

Masa administrative			
Periudhat e inspektimeve	Subjekte të Inspektuara	Masa administrative të aplikuar	% e masave administrative kundrejt subjekteve të inspektuara
8 mujore 2018	6,883	338	5%
8 mujore 2019	9,181	2346	25%

Në lidhje me numrin e dënimeve administrative si “Pezullim” për konstatim të shkeljeve flagrante të marrëdhënieve të punës, “Pezullim” për konstatim të shkeljeve flagrante të sigurisë dhe shëndetit në punë, masave administrative “palajmërim”, si dhe masave administrative “gjobë”, në inspektimet e realizuara në 12 degët rajonale të ISHPSHSH-së të dhënat rezultojnë si më poshtë:


<i>Inspektime Total (Private+Shtetërore)</i>						
<i>Deget Rajonale</i>	<i>Gjithsej/Inspektime</i>	<i>Pezullim/Marrëdhënie pune</i>	<i>Pezullim/Siguri në punë</i>	<i>Paralajmërim</i>	<i>Gjobjë</i>	<i>Vlerë (000)</i>
<i>Berat</i>	522	37	4	204	3	1,140
<i>Dibër</i>	250	36	16	31	3	572
<i>Durrës</i>	595	162	1	72	15	2,536
<i>Elbasan</i>	737	92	3	73	11	3,300
<i>Fier</i>	715	13	1	27	2	360
<i>Gjirokastrë</i>	182	5	0	-	1	100
<i>Korçë</i>	703	110	5	92	7	516
<i>Kukës</i>	326	98	0	87	5	2,542
<i>Lezhë</i>	407	69	4	59	7	2,304
<i>Shkodër</i>	723	69	1	6	7	2,560
<i>Tiranë</i>	3,189	237	17	138	28	6,079
<i>Vlorë</i>	832	145	1	338	4	300
<i>Total</i>	9,181	1073	53	1,127	93	22,309

Masat administrative

Kështu ndër masat administrative të vendosura në subjektet ekonomike inspektuar në këtë periudhë, rezulton se në 48% e këtyre masave ndëshkuese janë “Paralajmërim”, 48% janë “Pezullime” për shkelje flagrante, si dhe për 4% e masave ndëshkuese janë “Gjobja”

Inspektime Total (Private+Shtetërore)

MASAT ADMINISTRATIVE JANAR-GUSHT



Masa ligjore “Pezullim”

Masa ligjore “pezullim”, për shkeljet flagrante të dispozitave të legjislacionit të punës është aplikuar në 389 inspektime nga 127 të tilla në të njëjtën periudhë të një viti më parë ose 32.6 % më shumë. 87% e masave “pezullim” janë masa me ndikim për rregulleshmëritë e shkeljeve ligjore, evidentuar gjatë inspektimeve për marrëdhënie punë jo korrekte dhe 45 ose 12.7% janë për rregulleshmëritë e shkeljeve ligjore evidentuar gjatë inspektimeve për siguri dhe shëndet në punë.


Kjo masë ligjore është aplikuar më së shumti në degën rajonale Tiranë, Vlorë, Kukës, Korçë, etj, ndërkohë që në Gjirokastrë kjo masë nuk është aplikuar në asnjë inspektim të kryer.

Masa administrative “Pezullim” sipas degëve:

Degët Rajonale	Subjekte Total me masa administrativ	Subjekte me Pezullim	% e subjekteve me Pezullim
Berat	248	41	16.5%
Dibër	86	52	60.4%
Durrës	250	163	65%
Elbasan	179	95	53%
Fier	43	14	32.5%
Gjirokastrë	6	5	83%
Korçë	214	115	53.7%
Kukës	190	98	51.5%
Lezhë	139	73	52.5%

Shkodër	83	70	84%
Tiranë	420	254	60%
Vlorë	488	146	30%
Total	2346	1,126	48%

% e subjekteve me masa “Pezullim”, kundrejt numrit të masave administrative të marra




Masa administrative “Paralajmërim”

Degët Rajonale	Subjekte me masa administrativ	Subjekte me Paralajmërim	% e subjekteve me Paralajmërim
Berat	248	204	82.2%
Dibër	86	31	36%
Durrës	250	72	30%
Elbasan	179	73	41%
Fier	43	27	62%
Gjirokaster	6	-	0%

Korce	214	92	43%
Kukes	190	87	45.7%
Lezhe	139	59	42.4%
Shkoder	83	6	7%
Tirane	420	138	32.8%
Vlore	488	338	69%
Total	2346	1127	48%

% e subjekteve me Paralajmërim, kundrejt numrit të masave administrative të marra




Masa administrative “Gjobë”


Deget Rajonale	Subjekte me masa administrativ	Subjekte me Gjoba	% e subjekteve me Gjoba
Berat	248	3	1.2%
Diber	86	3	3.48%
Durres	250	15	6%
Elbasan	179	11	6%
Fier	43	2	4.6%
Gjirokaster	6	1	16%
Korce	214	7	3.2%
Kukes	190	5	2.6%

Lezhe	139	7	5%
Shkoder	83	7	8.4%
Tirane	420	28	6.6%
Vlore	488	4	0.8%
Total	2346	93	4%

% e subjekteve me Gjoha, kundrejt numrit të masave administrative të marra për muajt Janar-Gusht 2019




Nr i subjekteve me Gjohë sipas llojit të aktivitetit për muajt Janar- Gusht 2019.




Sipas llojit të aktivitetit të inspektuar rezulton se dënimet administrative të aplikuara gjatë inspektimeve janë:

	Subjekte të inspektuara Janar-Gusht 2019	Subjekte me Mase "Pezullim"	% e Subjekte me Mase "Pezullim"	Subjekte me Paralajmërim	% e subjekteve me Paralajmërim	Subjekt e me Gjobë	% e subjekteve me Gjobë
<i>Bujqësi, pyje, peshkim</i>	140	3	2%	6	4%	1	1%
<i>Miniera karriera</i>	205	34	17%	80	39%	10	5%
<i>Ndërmarrje Prodhuese</i>	1,807	93	5%	286	16%	25	1%
<i>Elektricitet, gaz, ujë</i>	91	14	15%	15	16%	2	2%
<i>Tregti, hotel-bar-restorante</i>	4,518	833	18%	427	9%	19	0%
<i>Ndërtim</i>	734	65	9%	128	17%	15	2%
<i>Transport, magazinim, telekomunikacion</i>	186	8	4%	25	13%	-	0%
<i>Finance, shërbime të sigurimeve</i>	105	4	4%	2	2%	-	0%
<i>Aktivitete të tjera</i>	1,395	72	5%	158	11%	21	2%
TOTAL	9,181	1,126	12%	1,127	12%	93	1%


Subjekte me Paralajmërim sipas llojit të aktivitetit për muajt Janar-Gusht 2019.



Masa ligjore "Pezullim" sipas aktivitetit



Subjekte me masën Gjobë sipas llojit të aktivitetit



Gjatë kësaj periudhe Inspektorati Shtetëror i Puneës dhe Shërbimeve Shoqërore ka ndjekur 34 procese gjyqësore nga të cilat:

- 16 çështje janë fituar (rrëzimi i kerkesë-padisë) Të përfunduara
- 3 çështje janë humbur, (shfuqizim akti)
- 6 çështje janë në vazhdim, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë .

Nga këto 34 procese janë rezultojnë si më poshtë:

- 25 Procese gjyqësore me subjektet për Gjobat
- 9 Procese gjyqësore për arrëdhënie pune.

Të ardhurat nga gjobat si 6 mujor janë 17.557.812 Lekë

Inspektime në kuadër të Deregullimit

Nga inspektimet tematike vlen të përmendim inspektimet e realizura me njoftim paraprak, opsion ky i ndryshuar në kuadër të deregullimit. Ku janë përfshirë tre shërbime me njoftim paraprak për të cilat subjektet nuk harxhojnë më kohë fizike dhe dokumentacion të sjellë pranë zyrave të Inspektoratit(gjithsej 8 dokumente), por shkohet me inspektim për këto 3 shërbime:

Konkretisht sipas 3 shërbimeve:

<i>Deget Rajonale</i>	Realizuar per autorizim per të mitur		Realizuar për autorizim orësh shtesë		Realizuar për autorizim për leje pune	
	Gjithsej	Femijë që u autorizuan	Gjithsej	Subjekte që u autorizuan	Gjithsej	Subjekte që u autorizuan
<i>Berat</i>	0	0	0	0	0	0
<i>Diber</i>	0	0	0	0	0	0
<i>Durres</i>	10	11	0	0	2	2
<i>Elbasan</i>	0	0	1	1	1	1
<i>Fier</i>	0	0	0	0	0	0
<i>Gjirokaster</i>	0	0	0	0	0	0
<i>Korce</i>	0	0	2	0	0	0
<i>Kukes</i>	0	0	0	0	0	0
<i>Lezhe</i>	0	0	1	1	0	0
<i>Shkoder</i>	5	4	0	0	2	0
<i>Tirane</i>	6	1	4	1	4	1
<i>Vlore</i>	2	2	0	0	1	0
<i>Qender</i>	0	0	0	0	0	0
<i>Total</i>	23	18	8	3	10	4

Inspektime për aksident në punë

Për periudhën Janar-Gusht 2019 janë regjistruar dhe për të cilët ka përfunduar hetimi administrativ i aksidentit në punë për 102 **raste të aksidenteve**, ku janë lënduar gjatë punës në të gjitha llojet e aktiviteteve 103 **punëmarrës**, prej të cilëve 27 me **pasoja të humbjes së jetës**. Për 73.8% të

punëmarrsve të aksidentuar shkaqet lidhen drejtpërdrejtë me kushtet e sigurisë dhe shëndetit në punë, dhe 70% e aksidenteve me pasojë fatale për jetën kanë ndodhur për këto shkaqe.

26.2% e punëmarrësve të aksidentuar në punë janë aksidentuar për shkaqe të ndryshme nga ato të kushteve të sigurisë dhe shëndetit në punë dhe nëse zbresim edhe rastet e aksidenteve në miniera të cilat nuk janë në kontrollin e drejtpërdrejtë të inspektorit të punës, kjo shifër shkon në 45.6% e rasteve të aksidenteve të ndodhura lidhen drejtpërdrejt me punën dhe që janë nën kontroll të inspektorit të punës.

Janë vlrësuar si aksidente në punë edhe rastet kur aksidenti ka ndodhur rrugës në linjën e drejtpërdrejtë nga banesa për në punë dhe anasjelltas, si në rastet kur transporti është i organizuar nga punëdhënësi ashtu edhe individualisht nga punëmarrësi. Këto përbëjnë 15 raste të aksidentuarve të ndodhura ose 14.5 % të aksidenteve të ndodhura, 4 prej të cilëve me pasojë të humbjes së jetës ose 14,8 % të rasteve të aksidenteve me vdekje.

Gjatë kësaj periudhe pranë ISHPSHSH-së janë raportuar edhe raste të ngjarjeve, të cilat i janë nënshtruar një procedure inspektimi nga ana e jonë, por në përfundim të hetimit administrativ të rastit, për arsye të ndryshme (mungesë të provave, dëshmitarëve, vendit të ngjarjes, mospërcaktim i shkakut të aksidentit që të këtë ardhur apo jo për shkak të punës etj), rastet nuk janë konfirmuar si aksidente në punë. Mund të sjellim si shembull dy rastet e aksidenteve me vdekje, në Durrës dhe në Gjirokastrë, apo rastet kur kishim të bënin me një ngjarjeje, në një fasoneri në Gjirokastrë, ku punëmarrësja shfaq shenja të alergjisë, gjendje për të cilën mjekët kompetentë e vlerësuan me 2 ditë raport, ku sipas nenit 29 të ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, klasifikohen si aksidente në punë, ato ngjarje që shkaktojnë paaftësi të përkohshme në punë më shumë se tre ditë kalendarike. Si edhe rasti në Tiranë, ku u aksidentua i vetëpunësuar (nuk kishte punëmarrës) me pasoja të lehta, dhe ku kishte më së shumti dëme materiale.

Inspektime për aksident Janar- Gusht 2019

Degët Rajonale	Inspektime	PezullimMar rëdhënie pune	Pezullim Siguri ne pune	Paralajmërim	Gjob ë	Vlerë (.000)	Pnm të aksidentuar	P/A/vdekje
Berat	5	0	1	2	2	1040	3	2
Dibër	13	0	0	9	1	260	15	3
Durrës	15	2	1	10	5	902	11	2
Elbasan	11	0	2	7	4	1080	10	4
Fier	5	0	0	0	2	360	5	1
Gjirokastrë	4	0	0	0	1	100	2	2
Korçë	7	0	0	1	1	100	7	2
Kukës	5	0	0	2	1	260	3	1
Lezhë	12	2	1	5	4	1680	9	4
Shkodër	5	0	0	0	3	1050	4	3
Tiranë	33	0	0	4	11	2520	30	3
Vlorë	3	0	0	2	1	50	4	0
Total	118	4	5	42	36	9402	103	27

Sipas degëve rajonale kemi që numri më i madh i inspektimeve për rast aksidenti në punë është kryer në degën rajonale Tiranë, Durrës, Dibër dhe Lezhë

Sa i takon inspektimeve për aksident në punë rezultojnë se në 35% të rasteve të inspektimit për shkak aksidenti është marrë masa administrative “Paralajmërim”, dhe në 30 % të rasteve është marrë masa administrative “Gjobë”.

Sipas llojit të aktivitetit ekonomik rastet e aksidenteve në punë rezultojnë:

Janar-Gusht 2019	Subjekte të inspektuara per shkak aksidenti në punë	Punëmarrës të Pnm të aksidentuar	Punëmarrës të Pnm te aksidentuar, me vdekje
Bujqësi, pyje ,peshkim	1	1	-
Miniera, karriera	19	21	6
Ndërmarrje prodhuese	28	20	2
Elektricitet, gaz, ujë	7	5	2
Tregti, hotel-bar-restorante	7	4	1
Ndërtim	29	26	11
Transport, telekomunikacion	-	-	-
Finance, shërbime të sigurimeve	-	-	-
Aktivitete të tjera	27	26	5
Total	118	103	27

Të dhënat mbi shëndetin dhe sigurinë në punë, evidentuar gjatë inspektimeve Janar-Gusht 2019

Të dhëna për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë Janar-Gusht 2019		Total
3	Subjekte ku ekziston dokumentit te vlerësimit të riskut	188
4	Subjekte ku ekziston këshilli i sigurisë dhe shëndetit në punë	2426
5	Numri i punëmarrësve të dyshuar, për sëmundje profesionale	40
6	Nr i punëmarrësve të diagnostikuar me semundje profesionale	35
7	Subjekte ku ka Shërbimi me mjek ndërmarrje	1799
8	Numri i punëmarrësve që punjnë me substanca të rrezikshme(te ekspozuar ndaj tyre	2927

9	Nr i punëmarrësve që përdorin Paisje mbrojtëse individuale	79658
10	Subjekte ku janë marrë Masat mbrojtëse kolektive	3619
11	Subjekte ku ekziston koordinatori për Sigurinë dhe shëndetin	532
12	Subjekte ku ekziston përfaqësuesi/Këshillit të sigurisë dhe Shëndetit në Punë	760
13	Subjekte ku ekziston shërbimi i ndihmës së parë	43
14	Subjekte ku kryhet Kontrolli periodik i punëmarrësve	1625

Inspektime për shkak ankese

Janë shtuar ankesat e ardhura drejt Institucionit tonë si shkak i ndërgjegjësimit të punëmarrësve dhe punëdhënësve, ku në total gjatë kësaj periudhe janë trajtuar 555 ankesa nga të cilat 362 me procedurë inspektimi.

Sa i takon zgjidhjes nuk është parë vetëm dhënia e të drejtës personit që adreson denoncimin, por dhe luftimi i fenomenit, i cili përmirëson marrëdhënien e punësimit për punëmarrësit që prekeshin nga e njëjta problematikë.

Janë trajtuar dhe denoncime të tjera të cilat janë trajtuar pa procedurë inspektimi por me të gjithë seriozitetin e duhur, duke dhënë informacionin e nevojshëm sipas rastit dhe delegim në Autoritetet përkatëse sipas fushës së kompetencës dhe specifikës që paraqitej.

Nga janari i këtij viti kjo shifër sëbashku me inspektimet për ankesë rezulton 555 ankesa të regjistruara dhe të trajtuara. Rreth 35 % e rasteve të trajtuara pa procedurë inspektimi, janë sqaruar në lidhje me pozicionin e tyre në raport me Legjislacionin e punës apo janë deleguar për kompetencë në organe të tjera ligjzbatuese, por që janë trajtuar me seriozitet maksimal nga struktura jonë. Vlen të theksojmë se të gjithë rastet e adresuara pranë nesh jemi kujdesur që të marrin përgjigje në kohën e duhur.

Nga “Platforma e Bashkëqeverisjes” janë adresuar pranë nesh 130 raste që denonconin shkelje të legjislacionit të punës, ose 23% e të gjithë denoncimeve të ardhura.

Sa i takon inspektimeve për shkak ankese rezultojnë se në 28 subjekte ose në 7% të rasteve është marrë dënim kryesor “Gjobë”, ndërkohë në 96 subjekte ose në 27% të këtyre inspektimeve është marrë dënim kryesor “paralajmërim”.

Inspektime për ankesë Janar-Gusht 2019

<i>Deget Rajonale</i>	Inspektime për shkak ankese	Pezullim/shkelje flagrante të marrëdhënie të punës	Pezullim/shkelje flagrante të sigurisë në punë	Masë administrative Paralajmerim	Masë administrative Gjore	Vlere (.000)
<i>Berat</i>	6	1	0	6	0	0
<i>Diber</i>	2	0	0	0	0	0
<i>Durres</i>	34	3	0	17	4	1140
<i>Elbasan</i>	10	1	0	2	1	260
<i>Fier</i>	9	1	0	2	0	0
<i>Gjrokaster</i>	-	0	0	0	0	0
<i>Korçë</i>	7	0	0	1	1	52
<i>Kukës</i>	2	1	0	0	1	2002
<i>Lezhë</i>	9	0	1	5	1	312
<i>Shkodër</i>	18	4	0	0	3	1030
<i>Tiranë</i>	230	25	3	41	14	2874
<i>Vlorë</i>	35	6	0	22	3	250
Total	362	42	4	96	28	7920

Numri më i madh i ankesave të trajtuara në këtë muaj është realizuar nga Dega Rajonale Tiranë me 230 inspektime për shkak ankese. Ndërkohë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë kemi

Te dhenat e inspektimeve

Inspektime Total (Private+Shtetore)

Inspektime për ankesë

<i>8 mujore 2018</i>	6,883	288
<i>8 mujore 2019</i>	9,181	362

Sipas llojit të aktivitetit ekonomik, inspektimet e kryera per rast ankese janë:

Lloji i aktivitetit	Subjekte të inspektuara për shkak ankese
Bujqësi, pyje ,peshkim	1
Miniera, karriera	4
Ndërmarrje prodhuese	84
Elektricitet, gaz, ujë	3
Tregti, hotel-bar-restorante	82
Ndërtim	14
Transport, telekomunikacion	11
Financë, shërbime të sigurimeve	9
Aktivitete të tjera	154
Total	362

Punëmarrësit.

Në lidhje me punëmarrësit e evidentuar në punë rezultojnë se:

50% e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrëse femra

1.7 % e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës që punojnë pa kontrata individuale pune.

31% e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës të siguruar në bazë të pagës minimale.

0.4 % e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës të huaj.

0.07% e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës me aftësi të kufizuar.

0.01% e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës nën 18 vjeç.

1 % e punëmarrësve të evidentuar ishin punëmarrës të pasiguruar (informal)

0.05 % e punëmarrësve të evidentuar ishin të aksidentuar.

Sipas degëve rajonale, kategoritë e të punësuarve evidentuar gjatë inspektimeve, rezultojnë:

Aktivitete private+shtetërore të inspektuara gjatë muajve Janar-Gusht 2019

Deget Deget Rajonale	Punëmarrës	Femra	P/Pa kontrata	P/page minimale	Të huaj	Me aftësi të kufizuar	Nën 18 Vjeç	Informal	U siguruar	P/aksidentuar	vdekje
Berat	7953	3977	204	5124	56	0	0	39	39	3	2
Dibër	8124	1045	54	606	155	63	0	23	23	15	3

Durrës	23051	14219	151	3792	15	0	84	320	316	11	2
Elbasan	8635	3166	178	4233	27	15	18	134	133	10	4
Fier	15527	5901	34	6555	77	9	6	38	38	5	1
Gjirokastrë	1617	921	195	851	0	3	5	8	8	2	2
Korçë	8094	3695	162	4363	286	0	0	210	206	7	2
Kukës	2424	631	322	1159	1	0	0	188	161	3	1
Lezhë	6841	3363	242	3794	87	16	7	102	102	9	4
Shkodër	10995	6333	219	6667	2	0	5	175	166	4	3
Tiranë	88875	49365	379	17775	118	42	26	447	440	30	3
Vlorë	15357	6564	1224	6213	30	0	73	379	377	4	0
Total	197493	99180	3364	61132	854	148	224	2063	2009	103	27
% kundrejt totalit		50%	1.7%	31%	0.4%	0.07%	0.1%	1%	1%	0.05%	0.01%

Kontrata individuale të punës:


Janë 3169 punëmarrës të evidentuar në aktivitetet private të inspektuara ose 1.7 % e totalit të punëmarrësve që janë konstatuar gjatë inspektimeve në muajt Janar-Gusht 2019 pa kontrata pune individuale.

Më konkretisht, numri i punëmarrësve evidentuar në punë pa kontrata pune individuale në 12 prefekturat e Vendit në subjekte private është,

Degët Rajonale		Aktivitete private të inspektuara Janar-Gusht			
		Subjekte	Punëmarrës	Punëmarrës pa kontrata	% e Punëmarrësve pa kontrata
1	Berat	518	7106	204	3%
2	Dibër	244	7414	54	1%
3	Durrës	591	21408	151	1%
4	Elbasan	732	8529	178	2%
5	Fier	714	13782	34	0%
6	Gjirokastrë	180	1558	195	13%
7	Korçë	702	8062	162	2%
8	Kukës	322	1905	188	10%
9	Lezhë	403	5982	242	4%

10	Shkodër	722	10961	185	2%
11	Tiranë	3184	87455	372	0%
12	Vlorë	823	13215	1,204	9%
	SHUMË	9135	187377	3,169	2%

Punëmarrës pa kontrata pune individuale kundrejt totalit të punëmarrësve të evidentuar në aktivitetet private të inspektuara.




Duke analizuar të dhënat mbi punëmarrësit e evidentuar pa kontrata pune individuale në llojet e aktiviteteve të kontrolluara rezulton se:

Sipas llojit të aktivitetit ekonomik numri më i madh i punëmarrësve pa kontrata pune individuale evidentohet llojin e aktivitetit Tregti Hotel Bar Restorante ku zë 26.2% të totalit të punëmarrësve evidentuar në punë, pa kontrata individuale.

	Lloji i aktivitetit	Subjekte private	Punëmarrës në subjektet private	Nr. punm. Pa kontrata individuale	% e punm. Pa kontrata individuale
1	Bujqësi, pyje, peshkim	140	1001	42	4%
2	Miniera, karriera	203	8327	45	1%
3	Ndërmarrje prodhuese	1804	75068	370	0.4%
4	Elektricitet, gaz, ujë	77	1861	17	1%
5	Tregti, hotel-bar-restorante	4518	37602	2038	5.4%

6	Ndërtim	733	13862	339	2%
7	Transport, telekomunikacion	186	3566	88	2%
8	Finance, shërbime të sigurimeve	105	1956	10	1%
9	Aktivite të tjera	1369	44134	220	0.4%
	TOTAL	9135	187377	3169	2%

Punëmarrësit evidentuar në punë pa kontrata individuale, sipas llojit të aktivitetit




Punësimi informal :

Gjatë muajve Janar-Gusht 2019, janë evidentuar 2063 punëmarrës informal ku gjatë procesit të inspektimit janë siguruar 2009 prej tyre, nëpërmjet masës administrative “pezullim” deri në sigurimin e tyre.

Theksojmë se 679 punëmarrës ose 33 % e punëmarrësve informal të konstatuar janë evidentuar në inspektime të programuara, 59 % në inspektime rastësore, dhe 6.2% % në inspektime për shkak ankese.

Krahasuar me vitin 2018 kemi 483 punëmarrës informal më shumë,

Të dhëna mbi informalitetin në vite



Të dhënat e mëposhtme janë për subjektet private dhe shtetërore

Degët rajonale		Aktivitete Private+Shtetërore të inspektuara			
		Subjekte	Punëmarrës	Informal	U siguruan
1	Berat	522	7,953	39	39
2	Diber	250	8,124	23	23
3	Durres	595	23,051	320	316
4	Elbasan	737	8,635	134	133
5	Fier	715	15,527	38	38
6	Gjirokaster	182	1,617	8	8
7	Korce	703	8,094	210	206
8	Kukes	326	2,424	188	161
9	Lezhë	407	6,841	102	102
10	Shkodër	723	10,995	175	166
11	Tiranë	3,189	88,875	447	440
12	Vlorë	832	15,357	379	377
SHUME		9181	197,493	2063	2009

Të dhënat për aktivitetet private të inspektuara

Degët rajonale		Aktivitete private të inspektuara			
		Subjekte	Punëmarrës	Informal	U siguruan
1	Berat	518	7106	39	39
2	Diber	244	7414	23	23
3	Durres	591	21408	320	316
4	Elbasan	732	8529	134	133
5	Fier	714	13782	38	38
6	Gjirokaster	180	1558	8	8
7	Korce	702	8062	210	206
8	Kukes	322	1905	188	161
9	Lezhë	403	5982	102	102
10	Shkodër	722	10961	175	166
11	Tiranë	3184	87455	440	434
12	Vlorë	823	13215	379	377
SHUMË		9135	187377	2056	2003

Aktivitetet ekonomike ku janë evidentuar punëmarrësit informal:

Punëmarrësit informal, sipas llojit të aktivitetit

Lloji i aktivitetit		Subjekte Private	Punëmarrës në subjektet private	Informal	% Informal, kundrejt punëmarrësve
1	Bujqësi, pyje, peshkim	140	1001	5	0.4%
2	Miniera, karriera	203	8327	28	0.33%
3	Ndërmarrje prodhuese	1804	75068	186	0.24%
4	Elektricitet, gaz, ujë	77	1861	16	1%
5	Tregti, hotel-bar-restorante	4518	37602	1456	4%
6	Ndërtim	733	13862	176	1%
7	Transport, telekomunikacion	186	3566	38	1%
8	Finance, shërbime të sigurimeve	105	1956	5	0.25%
9	Aktivitete të tjera	1369	44134	146	0.33%
TOTAL		9135	187377	2056	1.1%

- **Paga**

Punësimi me pagë minimale rezulton evident në 32 % të punëmarrësve të evidentuar në punë në aktivitetet private të inspektuara gjatë ketyre 6 muajve.

Lloji i aktivitetit (Subjekte Private)	Subjekte private	Punëmarrës në subjektet private	Punm. të siguruar mbi pagë minimale	% kundrejt totalit të punm.
Bujqësi, pyje ,peshkim	140	1001	677	68%
Miniera, karriera	203	8327	667	8%
Ndërmarrje prodhuese	1804	75068	25378	34%
Elektricitet, gaz, ujë	77	1861	211	11%
Tregti, hotel-bar-restorante	4518	37602	18879	50%
Ndërtim	733	13862	5116	37%
Transport, telekomunikacion	186	3566	1978	55%
Finance, shërbime të sigurimeve	105	1956	434	22%
Aktivitete të tjera	1369	44134	7660	17%
<i>Total</i>	9135	187377	61000	33%

• Inspektimi në Subjekte Fason

Në fokus të inspektimeve kanë qënë dhe subjektet Fason ku janë realizuar 231 Inspektime ose 5% e inspektimeve në subjekte private, me një numër 24876 punëmarrësish.

Numri i punëmarrësve që punojnë pakontratë individuale pune në këto lloj aktiviteti është shumë i ulët. Janë vetëm 159 punëmarrës që gjatë inspektimeve rezultuar të punojnë pa kontratë pune individuale nga 24876 punëmarrës në total.

Numri i punëmarrësve evidentuar të punonin informal është 50 për të cilët nëpërmjet marrjes së masës urgjente “Pezullim” të punës së tyre në 52 subjekte, deri në formalizimin dhe deklarimit pranë Tatim-Taksave, tashmë ato rezultojnë të futur në skemën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

Rreth 38.5% e punëmarrësve të evidentuar në punë në fasoneri rezultojnë që kontributi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore të llogaritet mbi pagë minimale dhe 0.21 % rezultojnë që të punojnë në turn të dytë.

Nr	Dega	Subjekte	Nr. P/M	Nr i Punëm, në turn të II-të (19 ⁰⁰ -22 ⁰⁰)	Nr i Punëmenen 18 vjeç	Nr i Punëm, pa kontratë individuale	Nr. Punëm, të pa siguruar	Nr. Punëm, që u futen në skemën e Sig	Nr punm, të siguruar me page min.
1	Berat	12	2288	3	0	0	0	0	1696
2	Dibër	3	243	4	0	1	1	1	45
3	Durrës	30	2395	0	4	0	0	0	0
4	Elbasan	8	343	0	0	0	0	0	269

5	Fier	20	2951	0	0	0	0	0	1948
6	Gjirokastrë	5	193	0	0	10	0	0	134
7	Korçë	25	1076	0	0	24	24	24	477
8	Kukës	1	103	0	0	0	0	0	101
9	Lezhë	15	2371	40	12	92	14	14	1265
10	Shkodër	18	1878	0	7	1	1	1	1094
11	Tiranë	70	8683	0	0	2	5	5	1592
12	Vlorë	24	2352	5	27	29	5	5	980
Total		231	24876	52	50	159	50	50	9601

Nga 231 subjekte Fason të inspektuara gjatë kësaj periudhe 47 kanë shkuar me masën administrative paralajmërim, dhe 6 subkete me sanksion në vlerën 1 720 000 lekë.

Dega	Subjekte	Masë urgjente për marredhënie pune	Masë urgjente për sigurinë në punë	Paralajmërim	Sanksion	Vlerë e gjobës (.000)
Berat	12	0	1	5	0	0
Diber	3	1	0	0	0	0
Durrës	30	0	0	3	1	100
Elbasan	8	0	0	0	0	0
Fier	20	0	0	2	0	0
Gjirokastrë	5	0	0	0	0	0
Korçë	25	3	0	4	0	0
Kukës	1	0	0	1	0	0
Lezhë	15	3	0	5	1	520
Shkodër	18	0	0	0	1	480
Tiranë	70	5	1	6	2	520
Vlorë	24	3	0	21	1	100
Total	231	15	2	47	6	1720

Fenomeni evident në këto lloje aktivitete është numri i punëmarrësve-kursantë. Kështu nga të dhënat e inspektimeve rezultojnë gjithsej 2570 kursantë nga të cilët 143 janë kursantë të marrë përmes Zyrave të Punësimit dhe 2427 rezultuan kursantë të kontaktuar drejtpërdrejtë nga vetë subjektet.

Dega	Subjekte	Nr. P/M	Nr i Punëm Kursante, marrë përmes zyres së punës	Nr i Punëm Kursante kontaktuar drejtpërdrejtë nga subjekti
Berat	12	2288	20	0
Dibër	3	243	25	0

Durrës	30	2395	0	0
Elbasan	8	343	0	0
Fier	20	2951	21	0
Gjirokastrë	5	193	25	0
Korçë	25	1076	0	0
Kukës	1	103	0	0
Lezhe	15	2371	0	2371
Shkodër	18	1878	0	0
Tiranë	70	8683	3	1
Vlorë	24	2352	49	55
Total	231	24876	143	2427

Gjithashtu janë përgatitur disa udhëzime për zbatim nga inspektorët e punës në terren, në lidhje me mënyrën e inspektimit për efektivitetin e Këshillave të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, Dokumentin e Vlerësimit të Riskut, mjekun e ndërmarrjes, përdorimin e paisjeve mbrojtëse individuale dhe kolektive, sinjalistikën në vendin e punës dhe elementë të tjerë të rëndësishëm të sigurisë dhe shëndetit në punë, me qëllim zbatimin sa më korrekt të këtij legjislacioni.

INSPEKTIMI I STANDARTEVE TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE

DISSSHSH ka inspektuar dhe vlerësuar gjatë periudhës Janar-Gusht 2019 **gjithësej 94 qendra të ofrimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.**

1. **Të inspektuara të programuara janë 75** qendra publike dhe jopublike që ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror.
2. **Të inspektuara e të paprogramuara janë 6** qendra përkujdesi shoqëror, nga të cilat, 4 për procedurë të liçensimit dhe 2 për trajtim ankese.
3. Është **vlerësuar situata e përgjithshme në 13 njësi shërbimi të përkujdesit shoqëror**, shërbime të reja komunitare shumëdisiplinore, të krijuara nga Bashkitë vetë apo në partneritet.

1. Vlerësim i përgjithshëm për qendrat e përkujdesit të inspektuara në muajin Korrik.

Në përfundim të inspektimit të qendrave jopublike të përkujdesit shoqëror në Qarkun Kukës, vlerësohet kontributi shoqatave humanitare apo ndërkombëtare, në mbështetje të fëmijëve,

individëve, familjeve dhe në tërësi të komunitetit në nevojë, si dhe përpjekjet e tyre për ofrimin e shërbimeve komunitare me cilësi dhe standarte.

Konstatohet si zhvillim pozitiv vënja në funksionim në vitin 2019, nga ana e Fondacionit Terre des hommes Misioni Shqipëri-Kosovë, e Qendrës për Shërbimeve Multifunkionale Kukës. Vlerësohet kjo qendër për kapacitetet dhe garancitë në drejtim të qëndrueshmërisë së shërbimit, në kontekstin e mungesës së shërbimeve alternative dhe të qëndrueshme të ofruara nga shoqatat lokale.

Shoqatat lokale nuk kanë një profil të plotë në fushën e shërbimeve të përkujdesit shoqëror. Fusha e aktivitetit të tyre nuk është vetëm ajo e kujdesit shoqëror, por mirëqeverisja, fusha e arsimit, drejtësia për të miturit, etj. sigurisht dhe këto të varura nga politikat e organizatave, institucioneve ndërkombëtare që financojnë projektet e tyre afatshkrutëra. Këto shoqata kanë nevojë të mbështeten për implementim të projekteve në fushën e kujdesit shoqëror, mbështetje e cila do të ketë kishte impakt jo vetëm në plotësimin e nevojave të komunitetit, por shërbimi i ofruar do të jetë cilësor, me standarte dhe i matshëm.

2. Inspektimi i Shtëpisë së Foshnjës Vlorë, për trajtimin e problemeve të ngritura nga ASHDMF, shkresa Nr. 1377 Prot. datë 08.07.2019.

Shtëpia e Foshnjës Vlorë ofron shërbimin e përkujdesit rezidencial në një godinë të vjetër, të amortizuar si edhe që nga Janari 2019 është me staf të paplotësuar, (5 punonjës, përfshirë këtu edhe punonjës social). Për situatën e konstatuar, vlerësohet që Bashkia Vlorë mban përgjegjësi në cilësinë e administratorit të “Shtëpisë së Foshnjës Vlorë” dhe në përgjegjësinë që i ngarkon Ligji Nr.121/2016, datë 24.11.2016, “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, dhe i’u bë me dije së mosmarrja e masave në vijim, do të përbëjë shkak për propozim të masave administrative të parashikuara, nga ligji sipërcituar.